



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) NR. 05/2016
PËR PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË KËRKESËS DHE NJOFTIMIT PËR FILLIMIN E HETIMEVE PËR IMPORTE TË
DAMPUARA OSE TË SUBVENCIONUARA

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MTI) NO. 05/2016
ON THE CONTENT OF THE APPLICATION FORM AND NOTICE FOR INITIATING INVESTIGATIONS ON DUMPED OR
SUBSIDIZED IMPORTS

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MTI) BR. 05/2016
O SADRŽAJU FORMULARA ZAHTEVA I OBAVEŠTENJA ZA POČETAK ISTRAGE ZA DAMPIRANE ILI
SUBVENCIONISANE UVOZE

Ministrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Në bazë të Nenit 27 paragrafi 3, Nenit 29 paragrafi 3 dhe Nenit 56 të Ligjit Nr.04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe Shtojcën 8 të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr: UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) Nr. 05/2016 PËR PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË KËRKESËS DHE NJOFTIMIT PËR FILLIMIN E HETIMEVE PËR IMPORTE TË DAMPUARA OSE TË SUBVENCIONUARA	Minister of the Ministry of Trade and Industry In accordance with Article 27, paragraph 3, article 29, paragraph 3 and Article 56 of the Law No. 04 / L-240 on Anti-dumping and Countervailing Measures, as well as Article 8 paragraph 1, subparagraph 1.4 and Annex 8 of the Regulation no.02 / 2011 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, issues the following: ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MTI) No. 05/2016 ON THE CONTENT OF THE APPLICATION FORM AND NOTICE FOR INITIATING INVESTIGATIONS ON DUMPED OR SUBSIDIZED IMPORTS	Ministarka Ministarstvo Trgovine i Industrije Na osnovu člana 27, stav 3, člana 29, stav 3. i člana 56, Zakona br. 04/L-240, o Anti-damping i kompenzatornim merama, kao i člana 8, stav 1, tačka 1.4 i Aneksa 8, Uredbe br. 02/2011, o Oblastima Administrativne Odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava, izdaje: ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MTI)Br. 05/2016 O SADRŽAJU FORMULARA ZAHTEVA I OBAVEŠTENJA ZA POČETAK ISTRAGE ZA DAMPIRANE ILI SUBVENCIONISANE UVOZE
---	--	---

Neni 1 Qëllimi Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet për paraqitjen e një kërkesë nga industria vendore ose shoqatat në emër të industrisë vendore të Kosovës, përmbajtja e formularit të kërkesës dhe përmbajtja e njoftimit për fillimin e hetimeve mbi dyshimet për importe të dampuara ose të subvencionuara.	Article 1 Purpose This Administrative Instruction sets out the conditions for the submission of a request by local industry or industry associations on behalf of the local Kosovo, content of the application form and the content of the notice for initiating investigations on suspicion of dumped or subsidized imports.	Član 1 Cilj Ovim Administrativnim Uputstvom se određuju uslovi za podnošenje zahteva od strane lokalnih industrijom i industrijskim udruženjima u ime domaće industrije Kosova, sadržaj formulara zahteva i sadržaj obaveštenja za početak istrage o sumnjama dampiranih ili subvencionisanih uvoza.
Neni 2 Fushëveprimi Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për masat antidamping dhe kundërbalancuese të cilat vendosen vetëm pas respektimit të procedurave përkatëse dhe kryerjes së hetimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara me Ligjin Nr.04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese dhe sipas rregullave të përcaktuara në shtojcat që janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.	Article 2 Scope This Administrative Instruction applies to anti-dumping and countervailing measures that shall be imposed only after respecting relevant procedures and carrying out investigations in accordance with the requirements established by the Law No. 04 / L-240 on anti-dumping and countervailing measures, according to the rules laid down in the annexes which are an integral part of this instruction.	Član 2 Delokrug Ovo Administrativno Uputstvo se sprovodi za anti-damping i kompenzacione mere, koja se postavljaju samo posle nakon poštovanja određenih procedura i obavljanja istrage u skladu sa zahtevima određenim Zakonom br. 04/L-240 o Anti-damping i kompenzacionim merama u skladu sa pravilima propisanim u aneksima koji su sastavni deo ovog uputstva
Neni 3 Përkufizimet 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:	Article 3 Definitions 1. The terms used in this Law shall have the following meanings:	Član 3 Definicije 1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeća značenja:

1.1. Komisioni - Komisionin e Vlerësimit të Detyrimeve të Veçanta të Importit të përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji; 1.2. Produkti me karakteristika identike – është produkti i ngjashëm në të gjitha aspektet me produktin nën hetim, apo në mungesë të një produkti të tillë, ndonjë produkt tjetër i cili edhe pse nuk është i ngjashëm në të gjitha aspektet ka shumë karakteristika të ngjashme me ato të produktit nën hetim, një kriter ky i rëndësishëm kur këto dy produkte konkurrojnë njëra tjetrën apo janë të zëvendësueshme; 1.3. Periudha e hetimit – është periudha e importimit të produktit i cili është nën hetim, e cila në kushte normale do duhej të ishte një periudhë prej së paku gjashtë (6) muajve dhe zakonisht një vit para dhe sa më afër dhe më e përshtatshme që është e mundur me fillimin e procedurës hetimore, me qëllim të vendosjes së dampingut apo subvencionimit dhe si pasojë e tyre, demit të shkaktuar. Neni 4 Kushtet për paraqitjen e një kërkesë (ankese) 1. Kushtet për paraqitjen e një kërkesë (ankese) sipas Ligjit Nr.04/L-240 për Masat	1.1. Commission- the Evaluation Commission of Special Import Duties established in Article 26 of this Law; 1.2. A product with identical characteristics - i.e. alike in all respects to the product under investigation or in the absence of such a product another product which although it is not alike in all aspects has many characteristics closely resembling those of the product under investigation, an important criterion being whether the two products are competing with each other or are substitutable; 1.3. Investigation Period –shall mean the period for importing a product that is under investigation, normally a period of at least six (6) months and usually one year prior and as closely as possible and appropriate to the initiation of the proceeding for the purposes of determining dumping or subsidization and the consequent injury caused. Article 4 Requirements for application of a complaint 1. Pursuant to the Law, the requirements for application of a complaint (appeal) by the	1.1. Komisija- Komisiju za procenu specijalnih uvoznih dažbina utvrđenim u članu 26 ovog zakona; 1.2. Proizvod sa identičnim karakteristikama – npr. sličan u svim aspektima sa proizvodom pod istragom, ili zbog nedostatka sličnog proizvoda, neki drugi proizvod koji, iako nije sličan u svim aspektima, ima mnogo sličnih karakteristika sa proizvodom pod istragom, jedan značajan kriterijum kada se ova dva proizvoda međusobno takmiče ili su zamenljiva; 1.3. Period istrage - uobičajeno period od najmanje šest (6) meseci i obično godinu prije i što je bliže moguće i primereno za pokretanje postupka za potrebe utvrđivanja dampinga ili subvencioniranja i sledstvenih prouzrokovanih povreda. Član 4 Uslovi za podnošenje jednog zahteva (žalbe) 1. Uslovi za podnošenje jednog zahteva (žalbe) prema Zakona, iz domaće industrije
--	---	--

Antidamping dhe Masat Kunderbalancuese, nga industria vendore e Kosovës ose në emër të saj, në mënyrë që të fillohet hetimi për masat antidamping dhe kundërbalancuese janë: 1.1. Dorëzimi i kërkesës me shkrim në pajtim me Ligjin Nr.04/L-240 për Masat Antidamping dhe Kundërbalancuese; 1.2. Një hetim mund të fillohet vetëm nëse konstatohet se kërkesa është bërë në emër të industrisë vendore së Kosovës, në bazë të një vlerësimi për shkallën e mbështetjes, ose kundërshtimit për ankesën, shprehur nga prodhuesit e Kosovës të produktit të ngjashëm. Ankesa do të konsiderohet se është paraqitur nga, ose në emër të industrisë vendore të Kosovës nëse është mbështetur nga ata prodhues të Kosovës prodhimi i përbashkët i të cilëve përbën baras ose me shumë se 50% të prodhimit total të produktit të ngjashëm të prodhuar nga ajo pjesë e prodhuesve të Kosovës që shpreh ose mbështetje ose kundërshtim për ankesën. Sidoqoftë, hetimi nuk mund të fillojë nëse prodhuesit e Kosovës që shprehimisht mbështesin ankesën përbëjnë më pak se 25% të prodhimit total të produktit të ngjashëm të prodhuar nga industria vendore e Kosovës.	local industry in Kosovo, or on its behalf, for initiating an investigation on Anti-dumping and Countervailing Measures are as follows: 1.1. Submission of a written complaint in accordance with the Law on Anti-dumping and Countervailing Measures; 1.2. An investigation shall be initiated only if determined that the complaint is submitted on behalf of the local industry in Kosovo, based on an evaluation of the extent to which the complaint is supported or objected by the Kosovo producers of the same product. The complaint shall be considered submitted by, or on behalf of the domestic industry of Kosovo, if it is supported by those Kosovo producers, whose joint production is equal to or more than 50% of the total production of similar product produced by the number of those Kosovo producers, which express either their support or opposition to the complaint. However, investigations shall not be initiated if Kosovo producers, which expressively support the complaint, are less than 25% of the total production of the similar product produced by the Local Industry of Kosovo.	Kosova, ili u njeno ime, tako da se počinje istraga za Anti-damping kompenzacione mere, su: 1.1. Uručenje pismenog zahteva u skladu sa Zakonom za Anti-damping i kompenzacione mere; 1.2. Istraga može početi samo ukoliko se utvrdi da je zahtev podnet u ime domaće industrije Kosova, na osnovu jedne procene za stepen podrške, ili protivljenja žalbe, izražene od strane proizvođača Kosova, jednog sličnog proizvoda. Žalba će se smatrati da je podneta od strane, ili u ime domaće industrije Kosova, ukoliko je podržana od strane proizvođača sa Kosova, čiji zajednički proizvod čini jedanko ili više od 50% totalne proizvodnje sličnog proizvoda proizvedenog od onog dela proizvođača Kosova, koji izjavljuju ili podršku ili protivljenje vezano za žalbu. Ipak, istraga se ne može pokrenuti ukoliko proizvođači Kosova, koji izričito podržavaju žalbu a čine manje od 25% totalne proizvodnje sličnog proizvoda proizvedenog od strane domaće industrije Kosova.
--	--	---

Neni 5 Kërkesa (ankesa) për vendosjen e masave antidamping dhe kundërbalancuese Përmbajtja e një kërkesë (ankese) ose informata që duhet të sigurohen, forma e plotësimit, deklarata e kërkesës (ankesës) dhe rregullat për paraqitjen e një kërkesë (ankese), janë të përcaktuara në Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ.	Article 5 Application (complaint) for imposing antidumping and countervailing measures The content or information to be provided, together with the completion method, statement of claim (application) and principles for submitting an application (claim), are presented in the Annex I of this Administrative Instruction.	Član 5 Zahtev (žalba) za postavljanje anti-damping i kompenzacione mere Sadržaj ili informacije koje se trebaju obezbediti, formular za popunjavanje, izjava zahteva (žalbe) i pravila za podnošenje jednog zahteva (žalbe), su predstavljeni u Aneksu I. ovog Administrativnog Uputstva.
Neni 6 Njoftimi për inicim të antidampingut Njoftimi për inicim të antidampingut, informatat që duhet të plotësohen dhe forma e hetimit janë të përcaktuara në Shtojcën II që është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.	Article 6 Notification for initiation of antidumping The notification for initiating antidumping, information to be provided and the investigation method are provided under Annex II, which is an integral part of this Administrative Instruction.	Član 6 Obaveštenje za iniciranje anti-dampinga Obaveštenje za iniciranje anti-dampinga, informacije koje se trebaju popunjavati i način istrage su dati u Aneksu II, koji je sastavni deo ovog Administrativnog Uputstva.
Neni 7 Hyrja në fuqi Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministrija e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.	Article 7 Entry into force This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after being signed by the minister of the Ministry of Trade and Industry.	Član 7 Stupanje na snagu Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane ministarke Ministarstva za trgovinu i industriju.

Hykmete Bajrami Ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Prishtinë, 28.04.2016 	Hykmete BAJRAMI Minister of the Ministry of Trade and Industry Prishtina, 28.04. 2016 	Hykmete BAJRAMI Ministarka Ministarstvo Trgovine i Industrije Priština, 28.04.2016
---	--	---

SHTOJCA I

DEKLARATA E ANKESËS

Shënim: Plotësoni tekstin si vijon, nën logon e kompanisë suaj. Zëvendësoni fjalët me shkronja italike në kllapa me terme të përshtatshme. Deklarata e ankesës të nënshkruhet nga personi i cili ka autorizim të parashtroj ankesë në emër të kompanisë ose asociacionit / shoqatës tuaj.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti i Tregtisë

Prishtinë

(data)

I/e nderuar,

(Emri i kompanisë ose asociacionit) është një ***(prodhues, fabrikant ose një asociacion-shoqate e prodhuesve ose fabrikantëve)*** të ***(mallrave)*** në Kosovë.

Kjo ankesë ka të bëjë me dampington ***(ose subvencionimin)*** e dëmshëm të ***(mallrave të importuara)*** me origjinë në ose nga ***(vendi ose vendet)*** eksportuese.

Unë, ***(emri, (pozita), e (emri i kompanisë ose asociacionit)***, vërtetoj se informatat dhe dëshmia në këtë ankesë të parashtruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

E nënshkruar: _____

PYETËSORI

1. Identifikimi i Parashtruesit të Ankesës

Jepni emrin e plotë, adresën, numrat e telefonit dhe faksit të prodhuesit(ve) ose asociacionit / shoqatës të Kosovës e cila (të cilët) e parashtron(jnë) ankesën. Identifikoni personin që duhet ta kontaktojme për më shumë informata.

2. Mallrat e Importuara

2.1 Përshkruani saktësisht mallrat e importuara për të cilat pohoni se janë objekt i dampingut dhe/ose të subvencionuara. Identifikoni dhe shpjegoni përdorimet dhe karakteristikat e tyre, përfshirë ato të cekura në [Shtojcën 1](#).

Nëse ka, siguroni të dhënat e produkteve për mallrat e importuara.

2.2 Nëse i keni, jepni numrat e klasifikimit tarifor të përdorur gjatë importimit të këtyre mallrave në Kosovë.

2.3 Cekni vendin ku janë prodhuar mallrat e importuara dhe prej nga janë eksportuar ato.

2.4 Identifikoni eksportuesit e njohur që i dërgojnë mallrat në Kosovë.

2.5 Identifikoni importuesit e njohur të mallrave në Kosovë.

2.6 Shpjegoni si tregtohen, u caktohen çmimet dhe shpërndahen mallrat e importuara në Kosovë.

3. Mallrat e Prodhuara në Kosovë

Veprimi ndaj importeve që janë objekt i dampingut ose të subvencionuara, mund të merret vetëm nëse industria prodhon mallra në Kosovë të cilat janë identike ose të ngjashme (gjegj. produkte të njëjta) me mallrat e importuara.

Përshkruani me saktësi mallrat që i prodhoni. Nëse nuk janë identike me mallrat e importuara, shpjegoni si dallojnë ato sa i përket përdorimeve dhe karakteristikave tjera (Përdorimet dhe karakteristikat që zakonisht kontrollohen janë cekur në [Shtojcën 1](#)).

Siguroni të dhënat e produkteve për mallrat që i prodhoni.

4. Klasat e Mallrave

Si mallrat e importuara ashtu edhe mallrat e njëjta të prodhuara në Kosovë, të marra si tërësi, ndonjëherë mund të ndahen në "klasa" ose "nën-grupime" më të vogla të mallrave.

Është e domosdoshme për ne të caktojmë nëse ekziston më shumë se një klasë e mallrave e përfshirë në këtë ankesë.

Si shembull, farat e bimëve të prodhuara në Kosovë do të mund të konsideroheshin si mallra të njëjta me farat e bimëve të importuara, për shkak se ato kanë përdorime dhe karakteristika të ngjashme. Do të thotë, ato kanë përdorim në përgjithësi të njëjtë, për të kultivuar bimë dhe mund të kenë karakteristika fizike dhe metoda të ngjashme të prodhimit. Mirëpo, ka gjasa që këto produkte, si tërësi, të mund të ndahen në klasa të veçanta të mallrave, si fara të luleve, fara të perimeve dhe fara të drithërave. Këto klasa të mallrave nuk konkurrojnë drejtpërsëdrejti me njëra tjetrën për konsumatorë të njëjtë, ato nuk plotësojnë nevojat e njëjta dhe nuk janë të zëvendësueshme.

A munden mallrat e importuara dhe produktet e njëjta që prodhohen në Kosovë të ndahen në klasa të veçanta të mallrave? Nëse po, shpjegoni në hollësi.

5. Industria e Kosovës

Para se të fillojë hetimi, kërkesa juaj duhet të ketë mbështetjen e industrisë përkatëse të Kosovës. Mbështetja e prodhuesit për kërkesë duhet të jetë më e madhe se pjesa e kundërshtimit dhe të paraqes jo më pak se 25% të tërë prodhimit të Kosovës.

5.1 Identifikoni të gjithë prodhuesit e njohur të mallrave të Kosovës.

5.2 Identifikoni të gjitha asociacionet-shoqatat e prodhuesve të produkteve të njëjta në Kosovë.

5.3 Jepni vëllimin dhe vlerën totale të prodhimit tuaj të produkteve të njëjta për tre vitet e fundit fiskale dhe vitin aktual deri më sot.

5.4 Llogaritni vëllimin dhe vlerën totale të produkteve të njëjta të prodhuara në Kosovë nga secili prodhues tjetër i njohur për tre vitet e fundit fiskale dhe për vitin aktual deri më sot. Shpjegoni si i keni llogaritur këto shifra.

5.5 A kini ndonjë informatë mbi pikëpamjet e prodhuesve tjerë të Kosovës lidhur me mallrat e importuara? Nëse e keni diskutuar këtë çështje me ta, jepni emrin dhe numrin e telefonit të personit ose personave të kontaktuar.

5.6 A keni ju, ose ndonjë prodhues tjetër i njohur i Kosovës, lidhje me eksportuesin ose importuesin e mallrave? Nëse po, identifikoni kompaninë dhe marrëdhëniet.

5.7 A importoni ju, ose ndonjë prodhues tjetër i njohur i Kosovës, mallrat në fjalë? Nëse po, jepni hollësi.

Pyetjet vijuese të pyetësorit kërkojnë informata dhe dëshmi të dampingut ose subvencionimit të pohuar të mallrave të importuara, si dhe dëshmi se ato mallra po e dëmtojnë industrinë e Kosovës.

Ndonjëherë, ju mund të mos jeni në gjendje të gjeni tregun, industrinë ose burime tjera informative që japin një pasqyrë të qartë ose të hollësishme të dampingut (subvencionimit) dhe trendet përkatëse të importit dhe efektet e dëmtimit në Kosovë. Konsultojeni së pari Ministrinë nëse disa nga informatat nuk janë lehtë të disponueshme. Ministria mund të jetë në dijeni për burime të tjera të cilat përmbajnë informata për këto çështje.

Në fund, mund të jetë e nevojshme që ju të bëni një llogaritje të arsyeshme për çështje të caktuara, duke shfrytëzuar informatat dhe burimet që i keni në dispozicion (përfshirë njohurinë dhe ekspertizën tuaj tregtare). Sigurohuni që të shpjegoni se si dhe çfarë keni përdorur për të bërë llogaritje të tilla

6. Dampingu

Në përgjithësi, dampingu ndodh nëse mallrat janë duke u shitur në Kosovë:

1. me çmime që janë më të ulëta se çmimi për produktet e krahasueshme në tregun e brendshëm të eksportuesit.
2. me çmime që nuk janë profitabile.

Çmimi profitabil i shitjes në vendin e eksportit është bazë për caktimin e "**vlerës normale**". Ndryshe, vlera normale mund të krijohet në bazë të kostos totale të mallrave dhe shumës së fitimit. Çmimi shitës në Kosovë quhet "**çmimi i eksportit**".

Në mbështetje të pohimeve tuaja se mallrat e importuara janë objekt i dampingut në Kosovë, ju duhet të llogaritni dhe krahasoni:

(6.1) vlerat normale; dhe

(6.2) çmimet e eksportit.

dhe të caktoni

(6.3) shumën e dampingut.

Krahasimi i vlerës normale dhe çmimit të eksportit

Identifikimi i mallrave të krahasueshme në tregun e brendshëm të eksportuesit (gjegj. produktet identike ose të ngjashme me ato të shitura në Kosovë) është një hap i rëndësishëm në sigurimin e krahasimit të drejtë ndërmjet vlerës normale dhe çmimit të eksportit.

Ngjashëm me këtë, që të dyjat, vlera normale dhe çmimi i eksportit duhet të shprehen në bazë neto (gjegj. Neto e zbritjeve të rëndomta, rabatat ose lejimeve tjera) duke përdorur të njëjtën njësi të masës (gjegj. për kg., për ton metrik, etj.) dhe të krahasohen me pikën e fundit të dërgimit/shitjes ose fabrikës (ose FOB).

Llojet, modelet, klasat e produkteve

Nëse ankesa juaj përmban disa lloje të ndryshme të produkteve ose klasa të mallrave të importuara në Kosovë, ju do të duhet të llogaritni vlerat normale, çmimet e eksportit dhe marzhat e dampingut, për një mostër që i përfaqëson më shumë lloje të ndryshme të mallrave.

Nëse të gjitha mallrat e importuara përbëhen nga i njëjti lloj i produktit, për tërë produktin përkatës mund të mjaftojë një llogaritje e dampingut në bazë të krahasimit të vlerës normale dhe çmimit të eksportit.

Aty ku ankesa përfshin mallrat prej më tepër se një vendi, ju duhet të bëni llogaritjen e vlerave normale, çmimeve të eksportit dhe marzhave të dampingut për secilin vend.

6.1 Vlera Normale

Në përgjithësi, për llogaritje të vlerave normale mund të përdoren dy metoda të ndryshme.

(A) METODA E PARË

Metodë e preferuar për llogaritje të vlerave normale, është përdorimi i çmimit shitës për blerësit jo të ndërlidhur në tregun e brendshëm të eksportuesit ku ato mallra shiten me një fitim.

Filloni me identifikimin e mallit të krahasueshëm. Më pas, siguroni informatat që i posedoni, mbi çmimet shitëse në tregun e brendshëm (vendor) të eksportuesit të këtyre mallrave. Kjo duhet të paraqes informatat mbi çmimet e fundit dhe preferohet që këto të mos jenë më tepër se një vit të vjetra.

Jepni dëshmi mbi çmimin e shitjes të cilin e keni përdorur si çmimoret, sondazhet e tregut, faturat e shitjeve, korrespondencat e shitjeve, ofertat, kuotat, etj.

Si shembull: mund të mjaftojnë 10 fatura në vendin eksportues ose kuota të çmimeve tjera,

Përpiquni të gjeni çmimet e regjistruara dhe çmimoret,

Nëse ka nevojë, llogaritni dhe mbështetni cilëndo njësi e cila duhet të zbritet nga çmimi i shitjes për ta sjellë atë **në shkallën neto të çmimit të fabrikës (ose FOB).**

Në vijim është një shembull i vlerës normale të llogaritur, duke përdorur si pikënisje çmimin e shitjes me pakicë në tregun e brendshëm të eksportuesit.

Skica 6.1(a)

Llogaritja e vlerës normale (duke filluar me çmimin e shitjes me pakicë në tregun e brendshëm të eksportuesit)

Në këtë shembull, ju keni marrë dëshminë e çmimit të shitjes me pakicë në tregun e brendshëm (vendor) të eksportuesit (250 njësi të valutës së vendit eksportues) të produktit të krahasueshëm me mallrat e shitura në Kosovë. Nga ky çmim i pakicës, ju keni llogaritur çmimin neto të fabrikës, duke zbritur njësitë përkatëse në vijim: Ngritja e çmimit të shitjes me pakicë (20%); rabatet e zakonshme vjetore të paguara nga shitësit me shumicë tek shitësit me pakicë (4% i çmimit të pakicës); ngritja e çmimit të shitjes me shumicë (20%) dhe kostot e eksportuesit/prodhuesit për transport dhe sigurim për dërgimin e mallrave shitësit me shumicë (10 njësi valutore).

Produkti i importuar Modeli A1

Produkti i krahasueshëm në tregun e brendshëm të eksportuesit
(ju e keni përcaktuar se produkti më i krahasueshëm është modeli A2) **Modeli A2**

Çmimi i shitjes me pakicë i modelit A2 në tregun e brendshëm të eksportuesit
(në valutë të vendit eksportues) **250 (për njësi)**

Më shkurtimisht:

(1) Ngritja e çmimit nga shitësi me pakicë =20%

(Ngritja e çmimit e shitësit me pakicë është ndryshimi ndërmjet çmimit blerës për mallra të shitësit me pakicë (gjegj. çmimi i shumicës) dhe çmimi i shitjes së pakicës. Zakonisht ngritja e çmimit merr parasysh të gjitha kostot e shitësit që ka të bëjë me blerjen dhe ri-shitjen e mallrave, siç është shitja, kostot e përgjithshme dhe administrative (S.G.&A.), dhe një shumë për fitim).

Çmimi i shitjes me shumicë 208
(llogaritja=250/1.2)

(2) Rabatet promovuese të shitjes të paguara në bazë vjetore nga shitësi me shumicë tek shitësi me pakicë

(4% e çmimit të pakicës =.04 x 250=10)

Çmimi (i paraqitur) neto i shumicës..... 198
(llogaritja=208 - 10)

Më shkurtimisht:

(3) Ngritja e çmimit nga shitësi me pakicë =20%

(Ngritja e çmimit e shitësit me shumicë është ndryshimi ndërmjet çmimit blerës për mallra të shitësit me shumicë (gjegj. çmimi i shitjes i eksportuesit/prodhuesit) dhe neto çmimi i shumicës. Në këtë shembull, ngritja e çmimit përfshin kostot S.G.&A. dhe kostot tjera të shitësit me shumicë lidhur me blerjen dhe ri-shitjen e mallrave, përfshirë detyrimet e transportit/ livrimit të cilat ia paguan shitësi me shumicë për shitje shitësit me pakicës dhe një shumë për fitim).

(Është caktuar) Çmimi i shitjes i eksportuesit/prodhuesit për shitësin me shumicë..... 165
(llogaritja=198/1.2)

Më shkurtimisht:

(4) Kostot e eksportuesit/ prodhuesit për transport dhe sigurim për shitjet në tregun e brendshëm (10 njësi valutore)

(Kostot e eksportuesit/ prodhuesit për transport dhe sigurim të cilat ia paguan eksportuesi/ prodhuesit për shitje shitësit me shumicë)

Çmimi i fabrikës i shitjes..... 155

(llogaritja =165-10)

Kursi i këmbimit –

(2 njësi valutore të vendit eksportues =1 Euro)

Vlera normale në Euro 77.50

(llogaritja =155/2)

Referencat mbështetëse -

Çmimi i shitjes së pakicës është marrë nga _____ i paraqitur në Shtojcën _____

Ngritjet e çmimeve nga shitësi me shumicë dhe pakicë dhe informatat mbi rabatet, janë marrë nga një sondazh i tregut nga _____ (ose janë llogaritur në bazë të ...). Shih Shtojcën _____ për kopje të faqeve përkatëse. Kostot për transport dhe sigurim të eksportuesit/prodhuesit të cilat i paguhen shitësit me shumicë për shitjet në tregun e brendshëm, bazohen në kuotën e çmimeve nga një bartës kryesor i transportit në tregun e brendshëm të eksportuesit, të bashkëngjitura në Shtojcën _____.

Kursi i këmbimit është mesatarja për vit _____ e cekur në ECB _____ (Shih shtojcën _____ për hollësi).

(B) METODA E DYTË

Metoda e dytë e llogaritjes së vlerës normale bazohet në të gjitha kostot e lidhura me prodhim dhe shitje të mallrave dhe të një shume për fitim.

Zakonisht, kjo metodë përdoret në rastet kur:

- E keni të vështirë të gjeni informata mbi çmimet për shitjet e mallrave të krahasueshme në tregun e brendshëm të eksportuesit;
- Nuk ka shitje të mallrave të krahasueshme në tregun e brendshëm të eksportuesit;
- Ju posedoni informata të cilat tregojnë se shitjet e eksportuesit në tregun e brendshëm janë në përgjithësi jo-profitabile; ose
- Shitjet në tregun e brendshëm të eksportuesit ju bëhen konsumatorëve përkatës, apo të afërt.

Në krijimin e kostos totale të njësive të mallrave, duhet të përdorni informata të bazuara në kostot e prodhuesve në vendin e eksportit.

Nëse nuk posedoni ato informata, kostot e kompanisë tuaj mund të përdoren për llogaritje të kostos totale të mallrave. Megjithatë, ju duhet të shpjegoni dhe përshtatni kostot tuaja për të llogaritur ndryshimet e njohura midis kostove tuaja dhe atyre të prodhuesit në vendin e eksportit, përfshirë ndryshimet në: normat-çmimin e punës, proceset e prodhimit (përfshirë dallimet teknologjike); kostot e lëndës së parë; madhësinë e ekonomisë, shkallën e shfrytëzimit të kapaciteteve; etj.

Në llogaritjen e kostos totale të njësive për mallra, cekni ndarazi:

- kostot e lëndës së parë, përfshirë artikujt kryesorë të lëndës së parë;
- kostot e drejtpërdrejta të punës (fuqisë punëtore);
- kostot e përgjithshme të fabrikës, përfshirë njësitë e përgjithshme kryesore;
- kostot e përgjithshme, të shitjes dhe administrative; dhe
- kostot tjera (specifikoni).

Shpjegoni si i keni llogaritur kostot e prodhimit dhe shitjes së mallrave dhe siguronit tërë dëshmitë me të cilat duhet të mbështetni këto kosto. Shpjegoni si e keni llogaritur shumën e fitimit.

Në vijim është paraqitur shembulli i vlerës normale e llogaritur me përdorim të kostos totale të mallrave dhe të një shume për fitim.

Skica 6.1(b)

Llogaritja e vlerës normale (bazuar në koston totale të mallrave dhe të një shume për fitim)

Në këtë shembull, për shkak se nuk keni mundur të mblidhni informata mbi caktimin e çmimeve në tregun e brendshëm të eksportuesit, ju keni llogaritur vlerën normale të bazuar në koston e krijuar totale të njësisë së mallrave, duke përdorur të dhënat e koston dhe një shumë të fitimit nga burime të ndryshme.

Produkti i importuar..... Modeli A1

Produkti i krahasueshëm në tregun e brendshëm të eksportuesit Modeli A2

Kostot e procesit të prodhimit

(kostot janë shprehur në valutën e vendit të eksportit)

Lëndët e para

- **lënda e parë X40 (për njësi)**
- **lënda e parë Z35**

Fuqia punëtore..... 10

Energjia 15

Kostot tjera të përgjithshme të fabrikës 10

(specifikoni – amortizimi, mirëmbajtja dhe riparimi, etj.)

- **Kostot totale te prodhimit..... 110**

Kostot e përgjithshme, të shitjes dhe administrative.....25

(specifikoni – administrata, shitja, asistenca teknike etj.)

Kostot financiare.....10

- **KOSTOJA TOTALE PËR NJËSI.....145**

Shuma e fitimit @ 8%12

- **VLERA NORMALE – Çmimi i-fabrikës.....157**

Kursi i këmbimit-

(2 njësi valutore të vendit eksportues =1 Euro)

- **Vlera normale në Euro.....78.50**
(llogaritja=157/2)

Referencat mbështetëse -

Sasitë e importit, kostot e lëndës së parë, kostot e fuqisë punëtore, shpenzimet e përgjithshme të fabrikës dhe kostot e energjisë janë marrë nga raporti për industri nga _____ i paraqitur në Shtojcën _____

Lejohet një alokim për kostot e përgjithshme administrative dhe shitëse, si dhe kostot financiare, në bazë të përvojës tonë me kosto dhe ne i kemi përshtatur këto njësi pastaj për 10%, për të paraqitur përparësitë e mundshme të kostove të eksportuesit për këto njësi. Shih shtojcën _____ për një kopje të faqeve përkatëse.

Shuma e fitimit prej 8% (të koston totale) paraqet shumën mesatare të fituar nga industria në periudhën 3 vjeçare para dampingut të pohuar. Shih shtojcën _____për hollësi.

Kursi i këmbimit është mesatarja për vit _____ e cekur në ECB _____ (Shih shtojcën _____për hollësi).

6.2 Çmimi i eksportit

Në përgjithësi, çmimi i eksportit është çmimi i mallrave të eksportuara, i paguar nga importuesi në Kosovë.

Zakonisht llogaritet me përdorimin e njërës nga të dy metodat dhe duhet gjithashtu të llogaritet në shkallën neto të çmimit të fabrikës (ose FOB) në bazë të informatave të fundit për çmimet jo më të vjetra se një vit.

(A) METODA E PARË

Metoda e parë e llogaritjes së çmimit të eksportit bazohet në çmimin e shitjes të cilin ia ofron eksportuesi importuesit në Kosovë.

Nëse posedoni dëshmi, ofroni tërë dëshmitë të cilat i keni lidhur me çmimin e shitjes për importuesin në Kosovë, siç janë çmimoret; faturat e shitjeve; ofertat, ofertat me shkrim ose kuotimet e çmimeve; korrespondencat e shitjeve; raportet e shitësve; ose edhe raportet e Statistikave të Kosovës (të cilat mund të japin çmimet e importit për vendin përkatës).

Zbritni çfarëdo kosto të përfshira në çmimin e shitjes, që kanë të bëjnë me lëvizjen e mallrave në Kosovë, siç është transporti dhe sigurimi, detyrimet e rregullta, etj. për ta kthyer çmimin në nivel të çmimit të fabrikës. Ofroni dëshmi për të mbështetur shifrat e kostove të zbritura.

(B) METODA E DYTË

Nëse nuk mund të llogaritni çmimet e eksportit në këtë mënyrë, mund të përdorni metodën e dytë e cila fillon me çmimin e shitjes me të cilin mallrat e importuara janë rishitur në Kosovë. Nga ky çmim i rishitjes, zbritni të gjitha kostot dhe fitimet për ta kthyer çmimin në nivel të çmimit të fabrikës përfshirë:

1. ngritjen e çmimit për mallra nga importuesi (zakonisht përfshinë të gjitha kostot S.G.&A. – Shpenzimet e Përgjithshme dhe Administrative dhe kostot përkatëse të importuesit për blerje dhe rishitje të mallrave dhe shumën e fitimit); dhe
2. të gjitha kostot e lëvizjes së mallrave, si transporti dhe sigurimi (si në Kosovë, ashtu edhe nga vendi i eksportit në Kosovë), detyrimet e rregullta, etj.

Jepni tërë dëshminë që e posedoni lidhur me çmimin e rishitjes të mallrave të importuara në Kosovë, siç janë çmimoret; faturat e shitjeve; ofertat; korrespondencat e shitjeve, etj. Gjithashtu jepni edhe bazën për kostot dhe fitimet e zbritura nga ky çmim i shitjes për ta kthyer çmimin në nivel të çmimit të fabrikës siç janë ngritjet e publikuara të çmimeve në industri, normat e transportit publikisht të disponueshme, etj.

Ekzistojnë edhe arsye shtesë nëse çmimi i shitjes së eksportit është ndërmjet importuesit dhe eksportuesit të lidhur (si shembull, përmes marrëdhënies së kompanisë kryesore me filialin). Kontaktoni Ministrinë për më shumë informata nëse ekziston ky lloj i raportit/marrëdhënies.

Në vijim është paraqitur një shembull i një çmimi të eksportit, i llogaritur duke e shfrytëzuar çmimin e rishitjes së mallrave në Kosovë, nga importuesi si pikënisje.

Skica 6.2(b)

Llogaritja e çmimit të eksportit (duke filluar me çmimin e rishitjes së mallrave në Kosovë nga importuesi)

Në këtë shembull, ju keni marrë dëshmi të çmimit të dërgimit të shitjes nga distributori/importuesi në Kosovë tek shitësi me pakicë. Nga ky çmim, ju keni llogaritur çmimin neto të eksportit të fabrikës duke zbritur njësitë relevante. Aty përfshihen: ngritja e çmimit nga distributori (25%); transporti dhe sigurimi i eksportit nga fabrika e eksportuesit në Kosovë (5 Euro për njësi); dhe taksa e rregullt doganore prej 10%.

Produkti i importuar Modeli A1

Çmimi i dërgimit të shitjes nga Importuesi/Distributori tek shitësi me pakicë (Euro)
..... **90 (për njësi)**

Më shkurtimisht:

(1) Ngritja e çmimit nga Importuesi/Distributori=25%

(Ngritja e çmimit nga importuesi është ndryshimi ndërmjet çmimit të blerjes së mallrave nga importuesi (gjegj. çmimi i shitjes së eksportuesit) dhe çmimi i shitjes së importuesit për shitësin me pakicë. Në këtë shembull, ngritja e çmimit nga importuesi përfshin të gjitha kostot e tyre S.G.&A.- Kostot e Përgjithshme Shitëse dhe Administrative dhe kostot tjera lidhur me blerjen dhe ri-shitjen e mallrave, përfshirë detyrimet e transportit/ dërgimit në Kosovë për dërgimin e mallrave tek shitësi me pakicë dhe një shume për fitim).

Është caktuar çmimi i shitjes i eksportuesit për distributorin dhe janë paguar detyrimet
..... **72**
(llogaritja=90/1.25)

Më shkurtimisht:

(2) Transporti, trajtimi & sigurimi nga eksportuesi prej 5 Euro 67
(kostot e pagueshme nga eksportuesi lidhur me lëvizjen e mallrave nga vendi i eksportit në Kosovë)

Më pak:

(3) Detyrime të rregullta prej 10% 60.30
(llogaritja=67/1.10)

- **Çmimi i fabrikës i eksportit në Euro 60.30**

Referencat mbështetëse -

Çmimi i shitjes i importuesit/distributorit është marrë nga katalogu i çmimeve (ose sondazhi i tregut, çmimorja, faturat, etj) të paraqitura në Shtojcën _____. Informatat mbi ngritjen e çmimeve, si dhe kostot e transportit dhe sigurimit janë marrë nga sondazhi i tregut nga _____ ose janë llogaritur në bazë të _____. Shih shtojcën ____për një kopje të faqeve përkatëse.

6.3 Margjina e dampingut

Margjina e dampingut llogaritet duke zbritur çmimin e eksportit nga vlera normale.

Në vijim është shembulli i llogaritjes së margjinës së dampingut duke shfrytëzuar informatat nga shembujt e mëparshëm të vlerës normale dhe çmimit të eksportit:

Skica 6.3

Llogaritja e marzhës së dampingut

Produkti i importuar..... Modeli A1

Produkti i krahasueshëm në tregun e brendshëm të eksportuesit..... Modeli A2

1. **Vlera normale – çmimi i fabrikës (në Euro)**

(krijimi ka filluar me çmimin e shitjes së pakicës të produktit të krahasueshëm Modeli "A2" në tregun e brendshëm (vendor) të eksportuesit.....**78.50 (për njësi)**

2. **Çmimi i eksportit – çmimi i fabrikës (në Euro)**

(krijimi ka filluar me çmimin e shitjes tek Modeli A1, nga importuesi në Kosovë).....**60.30**

3. **Margjina e dampingut**

(vlera normale më e vogël se çmimi i eksportit) **18.20**

4. **Detyrimi në përqindje në kufi të Kosovës 30.1 %**

Gjërat tjera që duhet ti kemi parasysh, kur e bëjmë krahasimin e vlerës normale dhe çmimit të eksportit

Llogaritjet paraprake mund të mjaftojnë për të bërë krahasimin ndërmjet vlerës normale dhe çmimit të eksportit dhe për të formuar bazë të mjaftueshme për caktimin e marzhës së dampingut.

Megjithatë, nëse jeni në dijeni për **ndryshime të rëndësishme** midis mallrave të shitura në Kosovë dhe mallrave të shitura në tregun e brendshëm të eksportuesit, të cilat mund të **ndikojnë në krahasimin e drejtë të çmimeve midis dy tregjeve (gjegj. krahasueshmëria e çmimeve)**, ato duhet të shpjegohen.

Disa ndryshime tipike të cilat kanë efekt në krahasueshmërinë e çmimeve përfshijnë ndryshimet në nivelin e tregtisë ose sasi të blera.

Sa i përket nivelit të tregtisë, mund të ketë model të ndryshimit të çmimeve nga ana e eksportuesit për nivele të ndryshme të tregtisë. Këto ndryshime të çmimeve zakonisht paraqesin kostot dhe shpenzimet e sistemit të distribuimit dhe aktivitetet e shitjes për çdo lloj të shitjes (si shembull, mund të ketë kosto të ndryshme të shitjeve dhe harxhimeve kur bëhet krahasimi i shitjeve të eksportuesit tek shitësit me pakicë në raport me shitjet e eksportuesit tek distributorët).

Për këtë arsye, nëse çmimi i eksportuesit i cili është përdorur për caktimin e vlerës normale nuk është në **nivel të njëjtë të tregtisë** si çmimi i shitjes së eksportuesit për importuesin në Kosovë, shpjegoni ndryshimin në nivele të tregtisë (përfshirë ndryshimet në aktivitetet e shitjes dhe distribuimit) dhe nëse ai mund të ndikoj në caktimin e çmimeve.

Arsye tjetër janë ndryshimet në sasi të blera midis dy tregjeve. Nëse çmimi i blerjes së eksportuesit i përdorur për caktimin e vlerës normale bazohet në shitje tek blerësit të cilët blejnë në sasi të mëdha (ose më të vogla) se sa importuesi në Kosovë, dhe ato ndryshime ndikojnë në çmimin e shitjes së mallrave, atëherë kjo duhet të shpjegohet.

Nëse dini ndonjë ndryshim tjetër të rëndësishëm i cili mund të ndikoj në krahasueshmërinë e çmimeve të mallrave, ju lutem shpjegoni dhe jepni hollësi mbi këto ndryshime.

7. Subvencionimi

7.1 Sipas njohurive tuaja, a i plotësojnë mallrat e importuara kushtet për subvencion të një qeverie të huaj? Nëse përgjigja është "jo", shkoni në kreun 8 - "Demonstrimi i dëmtimit".

7.2 Ofroni hollësi dhe dëshmi mbi subvencionet e njohura përfshirë:

- emrin e autoriteti të huaj i cili e jep subvencionin.
- shpjegimi rreth asaj se si funksion subvencioni;
- natyra/lloji i subvencionit të përfituar dhe shuma e përfitimit në industri/eksportuesit që i dërgojnë mallrat në Kosovë.

8. Demonstrimi i Dëmtit

Ju duhet të shpjegoni dhe ofroni dëshmi për të treguar se si mallrat që janë objekt i dampingut dhe ato të subvencionuara kanë dëmtuar industrinë e Kosovës.

Së pari, duhet të ofroni informata mbi **trendet e importit të përgjithshëm** lidhur me **vëllimin dhe çmimet** e mallrave që janë objekt i dampingut dhe ato të subvencionuara.

Së dyti duhet të ofroni informata dhe dëshmi të cilat tregojnë **efektet** e vëllimit dhe/ose nivelit të ulët të çmimeve të mallrave që janë objekt i dampingut dhe ato të subvencionuara në **industrinë vendore të Kosovës**. Zakonisht, këtu përfshihen informatat dhe dëshmia të cilat tregojnë se:

- importet po e zëvendësojnë prodhimin e mallrave të Kosovës; dhe/ose
- çmimet e ulëta të importeve po e detyrojnë kompaninë tuaj (dhe pjesën tjetër të industrisë së Kosovës) të ulin ose kufizojnë çmimet për të plotësuar çmimet e importeve që janë objekt i dampingut/të subvencionuara; dhe/ose
- produktet e importuara shkurtojnë çmimet tuaja në tregun e Kosovës.

E fundit, ju duhet të tregoni efektin e importeve që janë objekt i dampingut/të subvencionuara në faktorët tjerë të lidhur me dëmtim. Do të thotë, si kanë ndikuar importet në llogari të veçanta të shitjeve, fitimeve, etj.

Nuk është e domosdoshme që të gjithë faktorët e dëmtimit të tregojnë trend ose efekt negativ. Për shembull, derisa ju mund ta keni ruajtur vëllimin dhe pjesëmarrjen në treg si përgjigje në importet që janë objekt i dampingut/të subvencionuara, ndodh që kjo të jetë arritur vetëm për shkak se i keni ulur çmimet për t'u përshtatur me ato të mallrave të importuara.

Ngjashëm me këtë, ndoshta nuk do të jetë e nevojshme të jepen informata mbi të gjithë treguesit e cekur të dëmtimit. Në vend të kësaj, ju duhet të jepni një pasqyrë sa më të plotë dhe gjithëpërfshirëse, bashkë me dëshminë mbështetëse, për të treguar se dëmtimi është i konsiderueshëm dhe mund të lidhet me importet që janë objekt i dampingut/të subvencionuara.

8.1 Trendet në vëllim dhe pjesëmarrjen në treg të importeve që janë objekt i dampingut/të subvencionuara (gjegj. **importe të varura**) janë vlerësime të dëmtimit të rëndësishëm dhe mund të ndihmojnë në demonstrimin se importet në fjale po shkaktojnë dëmtim duke zëvendësuar prodhimin në Kosovë.

- a. Si hap i parë, ju duhet të ofroni hollësitë ekzistuese mbi vëllimin e importeve në fjale, për secilin nga tri vitet e fundit fiskale dhe vitin aktual deri sot.
- b. Më pas ju duhet të **krahasoni dhe shpjegoni** ndikimin e ndryshimeve në vëllimin e importeve në fjale në vëllimin e prodhimit dhe shitjeve në Kosovë. Ky krahasim shpesh bëhet duke ofruar të dhëna mbi ndryshimet në pjesëmarrjen në treg.

Pasi pjesa e tregut bazohet në përqindje të përmasës totale të tregut, ju zakonisht duhet të mblidhni informata për:

- importet e mallrave që thuhet se janë objekt i dampingut ose të subvencionuara;
- të gjitha importet tjera;
- prodhimin dhe shitjen e mallrave të kompanisë tuaj; dhe
- prodhimin dhe shitjen e prodhuesve tjerë të Kosovës.
(duke hequr dhe cekur ndarazi çdo aktivitet të eksportit për kompaninë tuaj dhe prodhuesit tjerë të Kosovës).

Këto lloj informatash më së miri paraqiten në formë të tabelës dhe ju do të duhet të konsultoheni me burime të ndryshme për të mbledhur informata të nevojshme për të llogaritur përmasën totale të tregut.

8.2 Lëvizja e çmimeve të importeve që janë objekt i dampingut ose të subvencionuara dhe efekti i tyre në çmimin e shitjes së mallrave të prodhuara në Kosovë është vlerësim tjetër i rëndësishëm për dëmtimin.

- a. Më së miri është nëse mund të ofroni informata mbi lëvizjen e çmimeve për importet ne fjale në pikën e parë të shitjes në Kosovë; dhe atë nga eksportuesi tek importuesi në Kosovë.

Aty ku importet e varura përbëhen nga lloje të njëjta të produktit, mund të jetë i dobishëm krahasimi i ndryshimeve në shifrat mesatare të çmimit të njësisë (për një periudhë të caktuar) për demonstrimin e tendencës së çmimeve.

Nëse importet ne fjale përbëhen nga shumë lloje të ndryshme të produkteve, modeleve ose klasave të mallrave, kontrollimi juaj i tendencës së çmimeve duhet të bazohet në mostrën përfaqësuese të llojeve të ndryshme të mallrave.

Në mungesë të informatave të hollësishme mbi caktimin e çmimeve për importet ne fjale, mund të konsideroni të përpiqeni të grumbulloni më shumë informata të përgjithshme mbi çmimet, siç janë informatat mbi indeksin e çmimeve, të cilat mund të ndihmojnë në demonstrimin e trendeve të çmimeve (siç është paraqitur në tabelën vijuese).

Shembulli – Indeksi i çmimeve për importet e varura

Indeksi i çmimeve statistikore të vitit bazë = 100

Indeksi i çmimeve statistikore të vitit 2 = 95

Indeksi i çmimeve statistikore të vitit 3 = 94

- b. *Si hap i dytë, duhet të krahasoni dhe shpjegoni edhe lëvizjen e çmimeve për importet ne fjale në tendencat e çmimeve për mallrat që i prodhoni.*
- c. *Lëvizja e çmimeve të rishitjes së importeve përkatëse në Kosovë mund të jetë mënyrë tjetër e kontrollimit të lëvizjeve të çmimit të importeve. Mirëpo, sigurohuni nëse çmimet e rishitjeve ndikohen në masë të konsiderueshme nga ndryshimet në praktikat e caktimit të çmimeve të kompanisë ndërmjetëse, e cila shet mallrat e importuara, më tepër se nga praktikat e eksportuesit për caktimin e çmimeve.*

8.3 Përveç ofrimit të informatave mbi lëvizjet e përgjithshme të çmimeve të importeve, duhet të jepni hollësi mbi instancat e veçanta ku çmimi i shitjes në Kosovë (ose çmimi i rishitjes së mallrave të importuara në tregun e Kosovës):

- a. ishte më i ulët se sa çmimi juaj i shitjes për mallra të njëjta;
- b. ju ka detyruar të ulni çmimin tuaj të shitjes për të konkurruar me çmim të produkteve të importuara;
- c. ju ka ndaluar nga ngritja e çmimit tuaj të shitjes, për të kaluar në rritje të kostos.

Ofroni dokumentacionin për të mbështetur pohimet tuaja si korrespondencën me konsumatorët; shënimet e bisedave; çmimoret; faturat e shitjeve; kuotimet e çmimeve; kontratat, ofertat, etj.

Si shembull, mund të kini pasur thirrje telefonike nga një konsumator juaj i rregullt, i cili kërkon nga ju të ulni çmimet e shitjes për 10% për t'u pajtuar me çmimin konkurrues të shitjes nga eksportuesi i mallrave që janë objekt i dampingut.

Si pjesë e dëshmisë tuaj, duhet të siguronit dokumentacionin e kërkesës së konsumatorit (n.m.tj / siç janë shënimet tuaja telefonike të bisedës) dhe përgjigja e kompanisë tuaj në kërkesën e konsumatorit. Për shembull, mund të jepni në ankesë deklaratën në vijim dhe dëshminë mbështetëse:

"Për shkak të rëndësisë së llogarisë së këtij konsumatori, kemi rënë dakord të ulim çmimet tona për 10% për konsumatorin "ABC" dhe patëm mundësi ta ruajmë shitjen.

Është i bashkëngjitur një shënim me hollësi të bisedës telefonike (përfshirë kërkesën e konsumatorit se ne jemi në përputhje me çmimet konkurruese të shitjes), dhe përgjigja jonë me faks (e cila konfirmon 10% të uljes së çmimit".

Faktorët tjerë të dëmtimit

Mund të ketë faktorë tjerë të dëmtimit lidhur me vëllimin e shtuar dhe/ose nivelin e çmimeve të ulëta të importeve që janë objekt i dampingut ose të subvencionuara. Pasonjë disa vlerësime të dëmtimit tipik dhe ju duhet të ofroni dëshmi të disponueshme që ju e posedoni për këto njësi.

8.4 Shitjet e humbura

- a. A keni shitje të humbura për konsumatorët e krijuar në importet që janë objekt i dampingut ose të subvencionuara?
- b. A keni humbur mundësi për shitje për konsumatorët e rinj potencial në importet që janë objekt i dampingut ose të subvencionuara?

